

12

T R A K T A T

EKSTRADIMI MIDIS MBRETNIS SHQIPTARE DHE SHTETEVE TË  
BASHKUEME-TE AMERIKËS

Shqipnia dhe Shtetet e Bashkueme të Amerikës, tue dashtun të të vinë në ndihmë të drejtësisë, kanë vendosun të lidhin midis të dy Shteteve një traktat për ekstradimin e t'aratisunve që iu shmangën në drejtësisë dhe kanë emëruar për këtë qëllim Fuqiplotët që vijojnë:

Nalt-Madhnija e Tij Mbreti i Shqiptarëvet:

Ekselencën e tij Zotin Djafer-Vila

Ministër i punëve të jashtëme:

Presidenti i Shteteve të Bashkueme të Amerikës:

Ekselencën e tij Zotin Herman Bernstein,

I dërguar i jashtzakonëshëm dhe Ministër Fuqiplotë i Shteteve të Bashkueme të Amerikës në Shqipëri; të cilët mbasi iu komunikuan njëri tjetrit fuqitë e plotat të tyre përkatëse që u gjetnë në formë të mirë dhe të duhur, ranë në ujdi dhe përfunduen artikujt që vijojnë:

Artikulli I.

Qeverija e Shqipërisë dhe Qeverija e Shteteve të Bashkueme pranojnë që t'i dorëzojnë drejtësisë, mbi kërkimin e bamë rregullisht si kundër parashifet këtu, cilindo person që mund të jetë akuzue ose mund të jetë dënue për silindo prej delikteve të caktuem në art. II të këtij traktati, krye mbrenda juridiksionit të njërës nga Palët e Nalta kontraktuese, dhe që ka për të kërkue strehë ose ka për t'u ndodhun mbrenda tokës së tjetrës; me konditë që ky dorëzim do të bahet vetëm mbas asish provash fajtorie që, simbas ligjevet të Shtetit ku i aratisuni ose personi i akuzuar si i tillë, ndodhet, mund të justifikojnë zënien dhe dorëzimin e tij për t'u gjykuar po të ish që delikti t'ish krye atje.

Artikulli II.

Do të dorëzohen ata persona që, simbas këtij traktati, do të jenë akuzuar ose dënuar për cilindo prej delikteve që vijojnë:

1. - Vrasje (dyke përshirë edhe deliktet e caktueme prej termeve: prindvrasje, helmim dhe foshnjëvrasje); vrasje me qëllim.
2. - Plagosje me qëllim ose lezion i randë trupor me paramendim.
3. - Turpërim me violencë, dështim, turpërim fëmijësh nën moshën 15 vjetësh.
4. - Rëmbim ose mbajtje grash ose vajzash për qëllime luksuri.
5. - Bigami.
6. - Vënie zjarri me paramendim.
7. - Prishje ose pengim me dashje dhe i paligjëshëm i hekuru-

dhave që vënë në rrezik jetën njerëzore.

8. - Delikte të kryeme në det:

a) Piratesi, sikundër njifet zakonisht dhe sikundër asht caktue prej së drejtës Ndërkombëtare ose prej ligjeve;

b) Fundosje ose prishje pa tëdrejtë të një anije në det ose tentative për gja të tillë;

c) Rebelim ose konspirim prej dy ose ma shumë pjesëtarësh të ekuipazhit ose personash të tjerë që ndodhen mbi një anije në det të hapët, me qëllim që të rebelojnë kundër autoritetit Kapitenit ose Komandantit të kësaj anije ose me mashtrim ose **Violencë** të shtiën në dorë këtë anije;

d) Msymje mbrenda në anie në det të hapët me qëllim lezioni trupor.

9. - Hyrje duke thyer ose hyrje me çdo mjet tjetër në godinë ose banesë për vjedhje.

10. - Hyrje duke thyer dhe hyrje me çdo mjet tjetër në zyrat qeveritare ose t'autoriteteve publike ose në të tjera ndërtesa që nuk janë banesa, me qëllim për të kryer një delikt aty mbrenda.

11) - Vjedhje me violencë frikësim.

12. - Kontrafaqim dhe vumje në qarkullim letrash të kontrafaqueme.

13. - Kontrafaqim ose falsifikim i akteve Zyrtare Qeveritare ose t'autoriteteve publike tue përshi edhe ato të gjykatoreve të drejtësisë, ose vumje në qarkullim ose përdorim me qëllim mashtrimi i një akti të tillë.

14. - Fabrikim monedhash të kontrafaqueme si metalike ashtu dhe kartë; titujsh ose kuponash të kontrafaqueme të dttës publike të emetura prej Qeverivet Kombëtare, Shtetnore, provinciale, teritoriale, lokale ose bashkiake, bank-notash ose instrumentash të tjera të kredis publike, vulash, timbrash, kallëpesh monedhe dhe shejash të kontrafaqueme t'administratavet shtetnore ose publike dhe nxjerrja, qarkullimi ose përdorimi me qëllim mashtrimi i objekteve të sipërpërmendun.

15. - Pervertim (keq-përdorim besimi).

16. - Grabitje e të miturve ose e **adulteve**, domethanë, rëmbim ose robërim i një personi ose personësh për të nxjerrë pare prej tyne, prej familjeve të tyne ose prej ndonji personi tjetër ose personash të tjerë, ose për çfarëdo qëllimi të paligjëshmëm tjetër.

17. - Vjedhje, domethanë vjedhje teshash, sendesh personale, ose paresh, me vleftë prej njëzet e pesë dollarësh ose ma tepër ose me aqë vleftë në monedhë shqiptare.

18. - Obtenim paresh, titujsh me vleftë ose pasuninash të tjera me dinakëri, ose marrje e çfarëdo paraje, titujsh me vleftë ose pasuninash të tjera tue ditun se këto kanë qënë shti në dorë me mënyra të pa-

ligjëshme, kur shuma e përeve ose vlefata e sendeve të obtueme ose të marruna me këtë mënyrë kalon dyqind dollarët ose njetë vleftë në monedhë shqiptare.

19. - Dëshmim i rëmë/

20. - Mashtrim ose keq-përdorim besimi nga an' e një depozitari, bankjéri, agjenti, komisionari, të besuari (trustee), ekzekutori, testamentari, administratori, tutori, drejtori, ose zyrtari të çdo shoqërie ose korporate ose nga an' e çfarëdo personi qi mban një pozitë besimi (fiduciare), kuer shuma e përave ose vlefata e pasurisë së përvetuar kalon dyqind dollarët ose ekuivalencën në monedhë shqiptare.

21. - Delikte kundër ligjeve të të dy Shteteve për çdukjen e sklavërisë dhe kundër tregëtimit të skllavëve.

22. - Neveritje dezhazi ose mos përkujdesje deshazi fëmijsh të mitun'ose të pa zot të shikojnë vehten ose personash të tjerë të tillë, me konditë që delikti të jetë i ndëshkueshëm prej ligjeve të të dy shteteve.

23. - Mite.

24. - Delikte kundër ligjeve të bankrutes.

25. - Delikte kundër ligjeve për të zhdukurtrafikun e narkotikëve.

26. - Gjithashtu ekstradimi ka për t'u ba edhe për bashkëpunim në cilindo prej deliktëve të nalt-përmendun si komplic para ose mbas ngjarjes ose në çfarëdo tentative për të kryer cilindo prej delikteve të sipër-përmehdura.

### Artikulli III.

Dispozitat e këtij traktati nuk japin të drejtë të kërkohet ekstradimi për ndonji delikt me karakter politik as për vepra që kanë lidhje me kësish delikte; dhe as një person i dorëzuem nga njana Palë e Naltë Kontraktuese tjetrës Palë, në themel të këtij traktati, nuk do të gjykohej ose ndëshkohet për ndonji delikt politik të kryem përpara ekstradimit, të tij. Shteti prej të cilit kërkohet ekstradimi ose gjykatoret e këtij Shteti, do të vendosin në se delikti ka karakter politik. Kur faji i ngarkuem asht ose vrasje ose asisininim ose helmim, qoftë i kryem qoftë i tentuar, fakti që faji asht krye ose tentuar kundër jetës së Sovranit ose Shefit të Shtetit të njenës nga palët e Nalta Kontraktuese, ose kundër sovranit ose Shefit të një shteti të huej, ose kundër jetës së ndonjanit prej antarëvet të familjes së tij, mjafton për të mos i dhënë këtij delikti karakter politik as për t'a lidhun këtë me deliktë me karakter politik.

### Artikulli IV.

As kush nuk do të gjykohej për ndo një delikt të kryem përpara ekstradimit të tij veç se për deliktin për të cilin asht dorëzue posë rasti kur ky ka qënë i lirë për një muej rrjesht të dalë jashtë Shtetit

mbasi të ketë qënë gjykue ose, në rast dënimi, të ketë vëjtun ndëshkimin ose të jetë falun.

Artikulli V.

Një kriminal i aratisun nuk do të dorëzohet, në mbështetje të dispozitave të këtij traktati, kur, për shkak parashikimi ose për arsye ligjore tjetër, si mbas ligjeve të Shtetit kërkues, kriminali përjashtë tohet nga ndjekja ose ndëshkimi për deliktin për të cilin kërkohet ekstradimi.

Artikulli VI.

Kur një kriminal i aratisun, ekstradimi i të cilit kërkohet sipas stipulatave të këtij Traktati, ndodhet nënë ndjekje, asht i liruem me garanci ose mbahet i burgosun për ndonji delikt të kryem në Shtetin ku ka kërkue strehë, ose ka qënë dënuepër atë delikt, ekstradimi i tij mund të shtyhet deri sa ndjekjet në fjalë të jenë përfundue dhe ay të jetë lirue si mbas dispozitave ligjore.

Artikulli VII.

Kur një kriminal i aratisun që reklamohet prej njanës nga të dy palët e kësaj Marrëveshtjeje, kërkohet edhe prej një ose ma tepër Shteteve, në bazë dispozitave të traktatave, për delikte të kryeme mbrenda juridiksionit të tyre, ky kriminal do të i dorëzohet atij Shteti kërkesa e të cilit ka arrijtun e para veç kur hiqet dorë nga kërkesa.

Ky artikull nuk do të cënojë traktatet që janë lidhun qysh ma parë prej njanës ose tjetrës nga Palët Kontraktuese me Shtete të tjerë.

Artikulli VIII.

Si mbas stipulatave të këtij traktati, as njana nga palët e Nalta Kontraktuese nuk do të jetë e detyrueme të ekstradojë shtetasit e vet veç kur shtetësija asht marrë mbas kryemjes të deliktit për të cilin kërkohet ekstradimi. Shteti prej të cilit kërkohet ekstradimi ka për të vendosun në se personi i reklamuem asht shtetas i tij.

Neni IX.

Shpenzimet e transportimit të të aratisunit do të paguhen prej Qeverisë që paraqet kërkesën për ekstradim. Nënepunësat kompetent të drejtësisë së Shtetit ku janë tue u krye veprimet e ekstradimit, do të ndihmojnë nëpunësit e Qeverisë që kërkon ekstradimin përpara gjykatësve dhe magjistratave përkatëse me të gjitha mjetet ligjore që disponojnë; dhe as një shpenzim nuk do të kërkohet nga Qeverija që reklamon ekstradimin përveç shpenzimeve për ushqimin dhe fjetjen e të aratisunit përpara dorëzimit të tij, të shkaktueme prej arrestimit, burgimit, hetimit dhe ekstradimit të të aratisunit si mbas këtij traktati por me konditë që nënëpunësi ose nënëpunëset e qeverisë dorëzuese që ndihmojnë, të cilët në vazhdim të rregullt të detyrës së tyre nuk kanë për të marrë asnjë rrogë ose shpër-

blim veç taksave specifike për shërbime të kryeme, do të kenë të drejtë të marrin nga Qeverija që kërkon ekstradimin, taksat e zakonëshme për veprimet ose shërbimet e kryeme prej tyre në mënyrën dhe, në sasinë sikur këto veprime ose shërbime të ishin krye në proceset penale ordinare si mbas ligjevet të Shtetit në shërbimin e të cilit ndodhen si nëpunës.

Neni X.

Çdo send që gjëndet në posedimin e kriminalit, të aratisun në kohën e arrestimit të tij, goftë se këto sende rrjedhin nga delikti goftë se, mund të përdoren si material prove në provimin e deliktit, me sa të jetë e mundun, si mbas ligjeve të sejcilës nga Palët e Nalta Kontraktuese, do të dorëzohen së bashku me personin në kohën e ekstradimit të tij. Si do goftë, të drejtat e një personi të tretë përsa u përket sendeve të nalt-përmenduna, do të respektohen duhesisht.

Neni XI.

Stipulatat e këtij traktati do të jenë të aplikueshme në të gjitha tokat kudo që të ndodhen, që janë nënë zotërimin e njanës ose tjetrës nga palët e Nalta Kontraktuese, ose nën okupimin dhe nën kontrollimin e njanës ose tjetrës prej tyre, sa kohë që vazhdon ky okupim ose kontrollim.

Kërkesat për ekstradimin e të aratisunve nga drejtësia do të bahen me anën e Agjentëvet Diplomatikë përkatëse të Palëvet të Nalta kontraktuese. Në rast të mos-ndodhjes së agjentave të till në Shtet, ose kur ekstradimi kërkohet nga ndonjë tokë e përfshime në paragrafin e parakaluem Posë Shqipënisë ose Shteteve të Bashkueme, kërkesat mund të bahen me anën e zyrtarëve eprorë konsullorë.

Arestimi i të aratisunit do të bahet në konformitet me ligjëet e Shteteve respektive dhe, në se, mbas një shqyrtimi, do të vendoset, si mbas ligjës dhe provave, që ekstradimi duhet të akordohet në bazë të këtij traktati, i aratisuni do të dorëzohet në konformitet me format e ligjës që disponojnë për ksish raste.

Personi i arestuem përkohësisht do të lirohet veç në rastin kur mbrenda dy muejve nga data e arrestimit në Shqipni, ose në Shtetet e Bashkueme, kërkesa formale për dorëzim bashkë me dokumentat provuese të përshkrueme këtu poshtë do të jenë paraqitun sikundër që përmëndet këtu sipër prej Agjentit Diplomatik të Qeverisë kërkuese ose, në mungesë të tij prej një nëpunësi Konsullor të asaj qeverie.

Në rast se kriminel i aratisun do të jetë dënue për deliktin për të cilin kërkohet ekstradimi i tij, duhet të paraqitet një kopje, duhesisht e autentikuar, e vendimit të gjykatores që ka caktue këtë dënim. Por,, kur i aratisuni asht vetëm akuzue me delikt, do të paraqitet një kopje, duhesisht e autentikuar, e mandantit të arrestimit të Shtetit, ku

asht krye delikti, së bashku me provën e fajsiës të përmendun në Art.I të këtij Traktati.

Neni XII.

Ky traktat, tekstet Shqip dhe Anglisht të të cilit janë njësisht autentike, do të ratifikohet prej palëve të Nalta Kontraktuese në konformitet me rregullat konsitucionale respektive dhe, do të hyjë në fuqi ditën e shkëmbimit të ratifikimevet që do të bahet në Washington sa ma shpejt që të jetë e mundun.

Neni XIII.

Ky traktat do të mbetet në fuqi prej një periudhe prej pesë vjetësh dhe, në rast se as njana nga palët e Nalta Kontraktuese, nuk do të ketë njoftue një vjetë para mbarimit të asaj periudhe qëllimin e vet për t'i dhanë fund Traktatit, ky do mbesë në fuqi deri në mbarimin e një vjeti prej datës në të cilën të jetë dhanë një njoftim i tillë prej njanës ose tjetrës nga Palët e Nalta Kontraktuese.

Në dëshmi të të cilavet Fuqiplotët e përmendun sipër e kanë nënshkrue këtë traktat dhe kanë vënë vulat e tyre mbi të.

Ba në dublikatë në Tiranë, sot të parën ditë të Marsit, njëmij e nëntëqind e tridhet' e tre.

Vijojnë firmat.

Artikulli II.

- Do të konsiderohen ato paragrafë që, sipas kësaj listë, do të jenë shprehur ose shprehur për cilindo prej deliktëve që vijojnë:
1. - Vrasje (që përfshin edhe deliktet e caktuar prej vendeve: grindvrasje, helim dhe fashnjëvrasje); vrasje me qëllim.
  2. - Plagosje me qëllim ose lesion i rëndë trupor me parashikim.
  3. - Turpërim me violencë, dhëmtim, turpërim rëndë me shprehje 15 vjetësh.
  4. - Shprehje ose shprehje grash ose vajzash për qëllim lëvizës.
  5. - Siguri.
  6. - Vrasje ajrore me parashikim.
  7. - Friksje ose pengim me detyrë dhe i paligjshëm i komunikimit.